



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 19 regjistër (JR)
Datë 18.05.2023

Nr. 38/1 i vendimit
Datë 31.10.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 31.10.2025, ditën e premte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 19/2023 (JR), datë 18.05.2023, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik, Florian Ballhysa.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 632, datë 08.03.2023 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në përputhje me parashikimet e neneve 60 dhe 65, pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi rezultatet e provimit përfundimtar të Shkollës së Magjistraturës si dhe parashtrimet me shkrim të paraqitura nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme të paraqitura pas këtyre rezultateve, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

1. Subjekti i rivlerësimit, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, për arsye se ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, i

është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).

2. Me vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas germës “b” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

2.1. Për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, Komisioni konstatoi problematika e mungesa të njohurive ligjore të cilat nuk plotësonin kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohej “i papërshtatshëm”. Mbi këtë konstatim, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit konsiderohet “i aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë; gjykim të drejtë; ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave dhe është eficient e efektiv në masë të pranueshme.

2.2. Për sa më lart, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti konsiderohet “i aftë” lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, bazuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 632, datë 08.03.2023, Komisioni vendosi të konfirmojë në detyrë subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia.

3. Kundër vendimit të sipërcituar të Komisionit, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, bazuar në rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ushtroi ankim Komisioneri Publik, z. Florian Ballhysa. Në ankim, Komisioneri Publik pretendoi se problematikat e konstatuara nga Komisioni, janë mangësi që afektojnë indikatorët e njohurive të ligjit, të parashikuara nga nenet 72 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016. Sipas Komisionerit Publik, mangësitë e konstatuara nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit njëvjeçar të Shkollës së Magjistraturës. Për këtë arsye, Komisioneri kërkoi nga Kolegji i Posaçëm të Apelit, ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.
4. Kolegji i Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e palëve, sikurse edhe shpjegimet gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, nën dritën e parashikimeve të nenit Ë, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 44, germa “b”, 60 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, me vendimin (JR) nr. 38, datë 25.07.2024, me shumicë votash, vendosi të ndryshojë vendimin e Komisionit nr. 635, datë 08.03.2023, nëpërmjet pezullimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurrikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës. Trupi gjykues i Kolegjit, arriti në këtë konkluzion pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të atilla që përbëjnë mangësi profesionale, të cilat mund të korrigjohen përmes programit të trajnimit.

4.1. Mangësitë që evidentoi Kolegji, u vlerësuan se paraqiten kryesisht në zbatimin e normave procedurale. Në analizën e kryer, trupi gjykues i Kolegjit në vendimin e tij, u bazua në sa rezultoi në aktet në fashikull, dhe mbajti në konsideratë parimet e përcaktuara në nenin 72 pika 4 të ligjit nr. 96/2016, për të mos gjykuar korrektësinë e vendimit, themelin e çështjes, dhe çështjet që janë trajtuar nga gjykatat më të larta, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që u vlerësua.

4.2. Për sa më sipër, mangësitë e konstatuara u vlerësuan se nuk e bënë subjektin e rivlerësimit të *papërshtatshëm* për vazhdimin e detyrës, por në kuptim të nenit 44, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, ishin të atilla që e kualifikonin në nivelin e kriterit të aftësive profesionale “me mangësi” dhe që mund të plotësoheshin nëpërmjet ndjekjes së një programi edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, hartuar për të plotësuar mangësitë. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe faktin se Komisioni e ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit pa problematika në kontrollin e dy kriterëve të tjera. Në të njëjtën linjë, as ankimi i Komisionerit Publik apo rekomandimi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, nuk kanë parashtruar rrethana që mund të sugjeronin çështje të tjera në funksion të procesit të rivlerësimit të subjektit, tej atyre të natyrës profesionale.

5. Vendimi i sipërcituar i Kolegjit (JR) nr. 38, datë 25.07.2024, për pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia, i është përcjellë Shkollës së Magjistraturës, me shkresën nr. {***} prot., datë 31.07.2024, me qëllim përgatitjen e programit të trajnimit njëvjeçar për subjektin, sipas kërkesave të nenit 6 të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016.

5.1. Shkolla e Magjistraturës, në datën 24.07.2025 [me shkresën nr. {***} prot.], në zbatim të nenit 60, pika 2¹ e ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 45/1 të Rregullores së Brendshme të saj, i dërgoi Kolegjit rezultatet e provimit përfundimtar të programit të trajnimit në vitin akademik 2024 – 2025, pjesë e të cilit ishte edhe subjekti i rivlerësimit. Në këtë shkresë, Shkolla e Magjistraturës ndër të tjera, është shprehur se subjekti i rivlerësimit ndoqi një program të veçantë trajnimi për profilin e tij si gjyqtar, të përbërë nga gjashtë lëndë. Në përfundim të programit dhe të provimit, bazuar në mënyrën e vlerësimit të përcaktuar nga Rregulloja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës dhe në planin mësimor, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar gjithsej me 85.76 pikë, të cilat janë 85.76 % sipas vlerësimit me shkallë, dhe vlerësimi me nivele është “Mirë”. Në përfundim, Shkolla e Magjistraturës është shprehur se bazuar në këtë vlerësim, subjekti i rivlerësimit e kalon me sukses programin e formimit sipas ligjit.

5.2. Pas kalimit procedural, sipas pikës 8² të nenit 179/b të Kushtetutës, këto rezultate iu njoftuan Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, i cili në parashtrimet e tij me shkrim drejtuar Kolegjit, vlerësoi se sipas rezultateve të dërguara, *duket se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka plotësuar/korrigjuar mangësitë profesionale të verifikuara në aspektin e vlerësimit profesional*.

6. Pas administrimit të akteve të mësipërme, trupi gjykues i mbledhur në dhomë këshillimi në datën 31.10.2025, konstaton se sipas rezultateve të provimit përfundimtar në përfundim të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia është vlerësuar gjithsej me 85.76 pikë, dhe vlerësimi me nivele “Mirë”. Në kushtet që Shkolla e Magjistraturës, ka konfirmuar përmbushjen me sukses nga subjekti i rivlerësimit të detyrimit që ka passjellë masa disiplinore e pezullimit, referuar vendimit jopërfundimtar të Kolegjit (JR) nr. 38, datë 25.07.2024, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se gjenden të plotësuar kushtet për dhënien e një vendimi përfundimtar për çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit objekt shqyrtimi. Me fjalë të tjera, duke mbajtur në konsideratë që subjekti i rivlerësimit e ka kaluar testimin e aftësive profesionale në përfundim të një programi trajnues të hartuar për të nga Shkolla e Magjistraturës, konkludohet

¹ 2. Në rast se subjekti i rivlerësimit përfundon programin e trajnimit, Shkolla e Magjistraturës i paraqet Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit dhe vëzhguesve ndërkombëtarë rezultatet e provimit përfundimtar, duke u shprehur nëse mangësitë janë mënjeluar ose jo.

² [...] Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të komisionit ende të papërfunduara do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.

që ai ka arritur nivelin minimal kualifikues të kërkuar nga shkronja “c” e pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 si parakusht për konfirmimin në detyrë.

7. Në vijim të sa më sipër, sipas një interpretimi *a contrario* [në të kundërt] të fjalisë së fundit të pikës 2 të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilës shkarkimi nga detyra është pasojë e mos kalimit me sukses të testimit të kryer nga Shkolla e Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë, në kushtet që ai e ka kaluar me sukses testimin e aftësive profesionale sipas programit të miratuar nga Shkolla e Magjistraturës. Së fundmi, meqenëse subjekti i rivlerësimit është konfirmuar përsa i përket dy kritereve të tjera, pasi është vlerësuar i *besueshëm* në kriterin e *pasurisë* dhe atë të *figurës*, trupi gjykues i Kolegjit çmon se alternativa e vetme e vendimmarrjes është ajo e konfirmimit të tij në detyrë.
8. Për sa më lart, në kushtet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit me sukses të testimit nga Shkolla e Magjistraturës, arrin nivel të besueshëm edhe për kriterin e vetëm për të cilin nuk kishte një qëndrim përfundimtar të institucioneve të rivlerësimit, dhe nevojës për marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me procesin e tij të rivlerësimit në kuadër të nenit 179/b, pika 7 e Kushtetutës, nenit 59, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmon se gjendet në kushtet e marrjes së një vendimi për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, duke përfunduar në këtë mënyrë procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit me një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Laurent Fuçia.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 31.10.2025.

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi -kundër

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, jam kundër vendimit (JR) nr. 38/1, datë 31.10.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), me të cilin është vendosur: *Konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia*, për arsyet më poshtë.
2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në shqyrtim shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik dhe parashtrimet e palëve, bazuar në nenin 5, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, nenin 44, shkronja “b” dhe në nenet 60 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 38 (JR), datë 25.07.2024, me shumicë votash, vendosi: *1. Ndryshimin e vendimit nr. 635, datë 08.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia. 2. Pezullimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia, për një periudhë njëvjeçare dhe detyrimin për të ndjekur programin e trajnimit, sipas kurikulave të miratuara nga Shkolla e Magjistraturës*, në të cilin kam votuar kundër, pasi kam vlerësuar se shkeljet e konstatuara në vendimin e Komisionit, të parashtruara në ankim nga Komisioneri Publik janë të asaj natyre që, në vlerësimin tim, nuk mund të korrigjohen/ndreqen me anë të trajnimit në Shkollën e Magjistraturës.
3. Në përfundim të programit të trajnimit, Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. {****} prot., datë 24.07.2025, bazuar në pikën 2 të nenit 60, të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenin 45/1 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës, ka dërguar pranë Kolegjit rezultatet e provimit përfundimtar të subjektit të rivlerësimit për vitin akademik 2024 - 2025. Bazuar në mënyrën e vlerësimit të përcaktuar nga Rregulloja e Shkollës së Magjistraturës dhe në planin mësimor, subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia është vlerësuar gjithsej me 85.76 pikë, të cilat janë 85.76% sipas vlerësimit me shkallë, dhe vlerësimi me nivele është “Mirë”. Bazuar në këto rezultate, Shkolla e Magjistraturës ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia e ka kaluar me sukses programin e formimit sipas ligjit.
4. Ndodhur në këtë situatë faktike, ligjore dhe procedurale, shumica e trupit gjykues në dhomë këshillimi, mbi bazën e rezultateve të provimit përfundimtar të Shkollës së Magjistraturës, me vendimin (JR) nr. 38/1, datë 31.10.2025, vendosi përsëri, me shumicë votash: *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Laurent Fuçia*. Kam konkluduar kundër vendimmarrjes së shumicës së trupit gjykues lidhur me kompetencën që ka Kolegji për gjykimin e kësaj çështjeje, konkretisht:
 - 4.1. Siç theksova edhe më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin nr. 38 (JR), të datës 25.07.2024, në zbatim të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 60 dhe 66, pika 1, shkronja “b” të tij, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe më pas pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra.
 - 4.2. Sipas këtij vendimi, subjekti i rivlerësimit Laurent Fuçia ka vazhduar trajnimin pranë Shkollës së Magjistraturës, sipas dispozitave Kushtetuese, për një afat njëvjeçar.
 - 4.3. Në përfundim të programit të trajnimit njëvjeçar dhe përfundimit të afatit të pezullimit për subjektin, si rregull, institucionet e rivlerësimit duhet të dalin me një vendimmarrje përfundimtare për subjektin e rivlerësimit Laurent Fuçia.
 - 4.4. Në nenin 5, pika 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se: Komisioni ose Kolegji i Apelimit, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Në çdo rast, vendimi jepet i arsyetuar. Vendimi që urdhëron pezullimin nga detyra, shoqëruar me detyrimin për trajnim, identifikon mangësitë. Gjatë periudhës së

pezullimit, të rivlerësuarit i njihet e drejta e pagës në masën 75 për qind të saj. Subjekti i rivlerësuar urdhërohet të ndjekë një program edukimi njëvjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, i hartuar për të plotësuar mangësitë. Në fund të programit, ai testohet për aftësitë e tij. Ky testim mbikëqyret nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit. Subjekti i rivlerësimit që nuk e kalon testimin, shkarkohet nga Komisioni.

4.5. Në vlerësimin tim, si gjyqtare në pakicë, në interpretim të nenit të cituar më sipër, çmoj se kompetencën për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, në këtë rast, e ka Komisioni.

4.6. Në nenin 179/b, pika 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet: *Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik është 5 vjet nga data e fillimit të funksionimit tyre, ndërsa mandati i gjyqtarëve të Kolegjit të Apelit është 9 vjet. Pas shpërbërjes së Komisionit, çështjet e papërfunduara të rivlerësimit shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Çështjet e papërfunduara të rivlerësimit të prokurorëve shqyrtohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, sipas ligjit. Pas shpërbërjes së Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit ende të papërfunduara, do të shqyrtohen nga Gjykata Kushtetuese.*

4.7. Në vlerësimin tim, kjo dispozitë përcakton qartë kalimin e kompetencave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit te Këshilli i Lartë Gjyqësor, për këtë arsye, në rastin konkret, procedura e rivlerësimit për subjektin Laurent Fuçia duhet të ishte trajtuar nga ky Këshill, pasi në referim të dispozitës ligjore të sipërcituar, Këshilli ka kompetencë kushtetuese të plotë për vendimmarrjen ndaj subjektit të rivlerësimit.

5. Këtë qëndrim timin e përforcon edhe fakti që Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 66 të ligjit nr. 84/2016, nuk mund të vendosë konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, në kapërcim të parashikimeve të pikës 1, shkronjat “b” dhe “c” të këtij neni, pra, pa vendosur ndryshimin apo prishjen e vendimit të Komisionit. Konfirmimi apo shkarkimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit, në përfundim të hetimit administrativ, vendoset vetëm nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 58, të ligjit nr. 84/2016, që në këtë rast e ka Këshilli i Lartë i Gjyqësor.
6. Një tjetër fakt i rëndësishëm, që mbështet qëndrimin tim, është se sipas dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, Kolegji i Posaçëm i Apelit vihet në lëvizje vetëm mbi bazën e ankimit të subjektit të rivlerësimit apo atë të Komisionerit Publik. Vlerësimi i dhënë nga Shkolla e Magjistraturës përmes shkresës nr. {***} prot., datë 24.07.2025, nuk mund të vërë në lëvizje Kolegjin e të trajtohet si ankim. Për këto arsye, në vlerësimin tim, shumica ka shkelur parimet kushtetuese, duke gjykuar një çështje pa ankim dhe duke marrë kompetencat e një institucioni tjetër kushtetues.
7. Vlerësoj se vendimi nr. 38 (JR), datë 25.07.2024, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndonëse nuk ka qenë përfundimtar për procesin e rivlerësimit për subjektin Laurent Fuçia, ka qenë në përputhje me kërkesat e nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: *Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji i Apelit vendos: a) lënien në fuqi të vendimit të Komisionit; b) ndryshimin e vendimit të Komisionit; c) prishjen e vendimit të Komisionit*, për pasojë, nga ana ligjore, ka natyrë përfundimtare.
8. Unë, gjyqtare në pakicë, vlerësoj që vendimi i dhënë nga shumica, është marrë në shkelje të rënda kushtetuese dhe ligjore, pasi *së pari*, shumica e trupit gjykues ka gjykuar një çështje në

dhomë këshillimi pa ankim, *së dyti* ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që konfirmimin në detyrë sipas kësaj dispozite e ka kompetencë ligjore vetëm Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pas përfundimit të hetimit administrativ, dhe *së treti* ka marrë kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kushtetues që shqyrton çështjet e papërfunduara të Komisionit, sipas nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

9. Referuar analizës më sipër, të argumentuar ligjërisht, çmoj se trupi gjykues i Kolegjit, në dhomë këshillimi, duhet të kishte vendosur dërgimin e akteve institucionit kompetent, Këshillit të Lartë Gjyqësor, për trajtimin e kësaj çështjeje.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi